



EUROPEAN RETURN FUND



# **RIKTHIMI NË KOSOVË: HISTORI RI-INTEGRIMI**

**QERSHOR, 2015  
BUDAPEST, HUNGARI**

## DEKLARATË MOHIMI

IOM-i i përmbahet parimit se migracioni i organizuar dhe human i shërben si migrantëve ashtu edhe shoqërisë. Si një organizatë ndërqeveritare, IOM-i vepron me partnerët e tij në komunitetin ndërkombëtar: për të ndihmuar në realizimin e të gjitha sfidave operacionale të migracionit; për të zhvilluar më tej kuptimin e çështjeve që lidhen me migracionin; për nxitjen e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik nëpërmjet migracionit; dhe për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe mirëqenien e migrantëve.

Opinionet e shprehura në këtë raport janë të autorëve të tij dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM). Emërtimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në raport nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni të çfarëdoshëm nga ana e IOM-it në lidhje me statusin ligjor të çdo vendi, territori, qyteti apo zone, apo të autoriteteve të tij, apo në lidhje me kufijtë e tij.

Ky botim është realizuar me ndihmën e Bashkimit Europian dhe bashkë financimin e Ministrinë së Brendshme Hungareze. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se përfaqëson pikëpamjet e Bashkimit Europian apo Ministrisë së Brendshme Hungareze.

Botues: Organizata Ndërkombëtare për Migracionin  
Rruga Tukory, 3  
1054 Budapest  
Hungari  
Tel: +36 472 25 00  
Fax: + 36 472 25 03  
Website: [www.iom.hu](http://www.iom.hu)

© 2015 Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

IOM ndërmori mbledhjen e informacioneve për këtë publikim me shumë kujdes dhe në besim të plotë. Megjithatë, IOM nuk mund të mbahet përgjegjëse mbi saktësinë e informacionit të dhënë dhe nuk mund të bëhet përgjegjëse për asnjë përfundim i nxjerrë nga informacioni. Ju lutemi të keni parasysh se informacioni mund të ndryshojë dhe rrethanat mund të variojnë sipas çdo rasti individual. Të gjithë personat kanë dhënë pëlqimin e tyre që tregimet e tyre të përdoren në këtë publikim. Për të ruajtur privatësinë e personave, ne kemi përdorur emra imagjinare përgjatë gjithë publikimit.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, regjistrohet, kopjohet ose transmetohet në çfarëdolloj forme apo me çfarëdolloj mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose të tjerë, pa marrë më parë miratimin me shkrim nga botuesi

## MIRËSEVINI !

Publikimi I mëposhtëm, i sjell për ju prej zyrës së Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në Budapest, është një përmbledhje e historive të treguara nga emigrantët Kosovarë të cilët u mbështetën në kuadër të programit të Kthimit Vullnetar të Asistuar dhe Ri-integrimit (AVRR).

Duke lexuar këto histori, duhet pasur parasysh që largimi nga vendi nuk është asnjëherë një zgjedhje e lehtë – dhe po aq e vështirë mund të jetë vendimi për tu rikthyer. Qëllimi ynë ka qenë të ndihmojmë emigrantët të marrin një vendim të informuar në lidhje me të ardhmen e tyre dhe për më tepër ti udhëheqim dhe mbështesim ata/ato në rrugën e zgjedhur.

Shumë prej historive në këtë libër flasin rreth personave të cilët ju desh të largoheshin nga vendi i tyre me shpresën për një të nesërme më të mirë, shpesh me qëllimin për të pasur kushte jetese më të qëndrueshme, jo vetëm për veten e tyre por dhe për ato të familjes që lanë pas. Këto lloj përpjekjesh zakonisht shoqërohen me sakrificë të mëdha, financiare por edhe jomateriale. Në rastet kur migrimi nuk është i suksesshëm, perspektivat për lulëzimin e tyre në vendin e origjinës, kanë tendencë të kthehen edhe më pak inkurajuese.

Për të luftuar këto probleme, që ishin shkaqet e migrimit dhe mund të ripërsëriten, asistencë e AVRR jepet për të lehtësuar ri-integrimin e qëndrueshëm. Me ofrimin e një rikthimi të asistuar dhe të denjë duke arritur pavarësi ekonomike, ne synojmë të ndihmojmë këta njerëz për të filluar një kapitull të ri. Personat që kanë ndarë historitë e tyre në këtë publikim janë dëshmia e gjallë që puna jonë po jep sukses.

Këto histori lejojnë që përvojat e emigrantëve të jenë në qendër të vëmendjes, dhe zërat e tyre të dëgjohen. Në këtë mënyrë ne shpresojmë të paraqesim një pasqyrë të asaj se si rikthimi, ri-integrimi dhe asistencë mund të sjellin rezultate pozitive për individët dhe komunitetet në vendet e tyre.

Shpresojmë ti shijoni tregimet!

Magdalena Majkowska-Tomkin  
Shefe e misionit të IOM në Hungari



## HYRJE

Shumica e emigrantëve që marrin pjesë në programin e Kthimit Vullnetar të Asistuar dhe Ri-integrimit (AVRR) të IOM Hungari, janë persona me origjinë Kosovare\*. Momentalisht, vështirësitë ekonomike, të cilat rezultojnë në mungesën e perspektivave është faktori kryesor shtyrës për personat që vendosin të emigrojnë prej Kosovës<sup>1</sup>. Që kur programet e para të asistencës u implementuan në vitin 2006, më shumë se njëqind shtetas kosovarë ju është dhënë asistencë ri-integruese në mënyrë që të kontribojnë në një rikthim të qëndrueshëm, duke lehtësuar situatën shumë të ndjeshme me të cilën këta të rikthyer shpesh përballen.

Hungaria, si vend destinacioni dhe vend kryesor tranziti i afërt me Kosovën\*, shërben si një pike kyçe për të informuar emigrantët në lidhje me skenarët e mundshëm që ata duhet të jenë të njohur kur të marrin vendimet në lidhje me udhëtimet e tyre të mëtejshme apo qëndrimin. Domethënë, duke bërë një konsideratë të thellë që çon në zgjedhjen e kthimit vullnetar, mund të shpëtoj njeriun në fjalë nga rreziqet e udhëtimit të mëtejshëm dhe të qënit një emigrant i pambror në kërkim të mundësive. Për më tepër, asistencë e ri-integrimit ka si qëllim lehtësimin e gjëndjes së ashpër ekonomike dhe mbrojtjen e dinjitetit të tyre si të kthyer.

Për marrjen e asistencës së ri-integrimit, i rikthyeri duhet të aplikojë duke përgatitur një plan ri-integrimi. Aplikimet dhe planet që shihen si të arsyeshëm, të realizueshëm dhe të qëndrueshëm mund të financohen me një asistencë deri në EUR 3,000, e cila mund të përdoret në lehtësimin e sipërmarrjes, edukimit ose punësimit. Momentalisht, raporti i personave që ju është dhënë asistencë e ri-integrimit është 11 përqind prej gjithë të rikthyerve.

Fondet për këtë projekt janë marrë prej Bashkimit Europian nga Fondi European Return 2013 si dhe nga Ministria e Brendshme Hungareze.

Njerëzit, eksperiencat e të cilëve paraqitet në këtë libër kanë marrë asistencë ri-integrimi si pjesë e programit AVRR të IOM Budapest ndërmjet Janar 2009 dhe Dhjetor 2013, dhe u intervistuan gjatë vizitës monitoruese të bërë gjatë 23 Shkurtit 2015 dhe 6 Marsit 2015. Këto vizita u kryen nga një delegacioni prej zyrës së IOM Budapest, dhe ndihmës dhe devotshmërisë së IOM Prishtina në Shkurt 2015. Një falenderim i veçantë duhet ti shkojë Zotit Esat Aliçkaj për ndihmën e paçmuar dhënë delegacionit, Zj. Linda Muqolli për përkthimin e bërë gjatë intervistave dhe Zt. Latif Hasolli për fotografitë e bëra që u përdorën në këtë publikim

<sup>1</sup> Më tej referuar si Kosova\*. Ky përcaktim bëhet pa paragjykuar pozitën e statusit dhe përputhet me Rezolutën e KSKB-së 1244/1999 dhe Opinionin e GjND-së mbi Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës. Në këtë raport, të gjitha referimet ndaj Kosovës në tekst, qofshin për territorin, institucionet apo popullsinë, duhen kuptuar në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykim ndaj statusit të Kosovës.

## Gëzim Gjuri – Bletari

Në 2012 Gëzim Gjuri vendosi te kthehej vullnetarisht ne Kosovë. Ai aplikoi në programin e kthimit vullnetar të IOM dhe u përzgjedh si fitues I grantit që e ndihmoi atë në biznesin e bletarisë, që përbëhej prej vetëm shtatë kosheresh para se ai të imigronte. Qysh prej asaj kohe ai e ka përdorur këtë grant për zgjerimin e atij biznesi bletarie që zotëronte prej kohësh, por që nuk prodhonte të ardhura te mjaftueshme në Kosovë.

Përveç përkrahjes konstante te familjes, ndihma e IOM ishte e vetmja ndihmë financiare e marrë për biznesin e tij pas kthimit nga emigracioni. Ai kujton se kur filloi biznesin e tij kjo ndihme financiare ishte më e rëndësishmja në stabilizimin e jetës së tij ne Kosovë, edhe pse – ai pranon - politikat në vendin e tij vazhdojnë të influencojnë mundësitë e tij. Për atë “ asistencë ishte mëse e mjaftueshme” dhe nëpërmjet asaj ai mundi të blej gjithë mjetet e nevojshme për bletarinë. Prej asaj asistencë kishte “akoma tepër dhe prej dy vitesh po shohim rezultatet e saj” tregon ai.

Qysh prej rikthimit me ndihmën e IOM Gëzimi mundi

te shumëfishoj numrin e koshereve te bletëve në menyre drastike. Njohuria që ai ka si bletëmbajtës dhe asistencë financiare që ai mori nga IOM mundësuan që biznesi i tij të shkëlqejë. “Ne mundemi ti plotesojmë nevojat tashmë” thote ai i kënaqur. Përpara se të largohej, përveç koshereve të bletëve, ai kishte dhe disa lopë dhe dele. Profitet nga biznesi i mjaltit i mundësuan Zt. Gjuri investimin e blerjes së një lope dhe viçi, duke rritur kështu të ardhurat për familjen e tij dhe krijimin e mundësisë për më shumë investime të tjera.

Edhe pse kërkesat për koshere dhe mjaltë nuk është stabile në ekonominë e Kosovës, Zt. Gjuri është në gjëndje të mirëmbaj biznesin e tij. Në vitin e kaluar ai mundi te shiste gjithë produktin e tij në shumicë në nje kompani dhe mundi të “merte më shumë para dhe ti merte njëhëresh”. Kjo e ardhur ishte një ndihmë e madhe në përmirësimin e mëtejshëm të kushteve të jetesës, duke investuar më shumë ne shtëpinë ku familja e tij jetonte. Për më tepër, ato të ardhura mjaftuan edhe për blerjen e një traktori, më shumë lopë dhe më shumë komoditete të cilat familja e tij nuk mundet ti përballonte më parë. Zt. Gjuri madje ka mundur të shesë mjaltin e tij deri në Dubai në vitet e fundit.



Zt. Gjuri dhe familja e tij ishin shumë të gëzuar kur aplikimi i grantit të tyre u aprovua, sepse ishte një ndihmë e madhe ne përballimin e jetesës së gjithe familjes prej dhjetë anëtarësh. “ Në fillim nuk besonin se do të aprovohej, por kur morëm lajmin...nuk mund të flinim dot tërë natën prej gëzimit” Gëzim Gjuri dhe mamaja e tij na kujtojnë emocionet prej asaj eksperience.

Marja e grantit të biznesit ishte nje proces i lehtë për Zt. Gjuri

i cili thotë se “ me IOM unë kam pasur vetëm eksperience pozitive”. Ai nuk ka asnjë propozim për të përmirësuar më shumë shërbimet që jep IOM.

Tani produktet e tij dhe ai vetë po bëhen më te njohur ne zonën ku jeton. Tregu i mjaltit, i cili është i ndërtuar mbi besimin, e ka afruar më shumë produktin organik, pa sheqer dhe kualitativ te Gëzim Gjurit. Ai ka mundur te zgjeroj tregun

ku e shet produktin e tij prej shitjes në familje, të afërm dhe të njohur nëpërmjet njohjeve dhe fjalës së përhapur në më shumë konsumator. Madje tani atij i venë vetë konsumator te ndryhëm që kanë degjuar më parë për të nga të tjerë. Edhe pse këto janë hapat e para, ai mendon se biznesi po shkon shumë mirë.

Në të ardhmen ai ka në plane te zgjeroj dhe më tepër kosheret e tij dhe bletarinë në njëqind

koloni. Për më tepër ai mendon hapjen e nje dyqani të vogël në qendër te Podujevës ose Prishtinës, ku ai do mund të shesë produktin e tij.

Emigrimi i Zt. Gjuri prej Kosove ne 2012 ishte “i pari dhe i fundit. Arritjet e tij dhe prospekti ne biznesin e bletarisë a ka bërë atë më konfident dhe të sigurtë kur deklaronte se “ unë nuk do shkoj kurrë më”.



## 2. Alban Mali – Mekanik

Alban Mali u rikthye në Kosovë pasi qëndroi më shumë se një muaj ne Hungari. Ai ishte njëri prej përfituesve të asistencës nga projekti i IOM. Zt. Mali u informua nga zyra IOM Budapest për mundësinë e aplikimit për grant biznesi. Në rikthimin e tij në Kosovë ai aplikoi dhe përfitoi asistencë për reintegrimin e tij, të cilën e përdori për të hapur një dyqan auto mekanike në Gjakovë, një prej qyteteve më të mëdha ne Kosovë\*.

Ndihma financiare e ofruar prej IOM, i dha mundësinë Mr. Mali të pajisi dyqanin mekanik të tij, me makineritë e nevojshme. Kjo asistencë, e vetmja që ai ka marrë prej kthimit të tij, dhe vullneti i tij për punë, ishin dy faktorët kryesorë në suksesin sipas atij.

Alban Mali ka punuar edhe më parë si mekanik dhe ka eksperience në këtë fushë. Por para se të emigronte ai ishte i punësuar në një auto mekanik me , “ vullnet per pune dhe profesion” siç na tregon

ai. Pas kthimit ne Kosovë vullnetarisht me IOM, ai pati mundësinë të hapte dyqanin e tij të riparimit mekanik, duke përdorur njohurinë, eksperiencën dhe njohjet që ai kishte.

Mospasja e fondeve ishte një nga pengesat që e ndalonte atë të hapte dyqanin e riparimit më përpara. Fondet e dhëna nga IOM ishin të mjaftueshme të kalonin pengesën e parë dhe pasjen e makinerive të para për nisjen e biznesit të tij. “ Edhe pse do më duhen me shumë mjete, sa për fillim është shumë mirë” na tregon ai.

Eksperiencia e Zt. Mali me IOM ishte “ korrekte dhe shumë e mirë”. Të dyja zyrat, ajo në Budapest dhe ajo në Prishtinë, i erdhën shumë në ndihmë atij. Zyra në Budapest “ më tha se duhet të prisja për një muaj për marjen e përgjigjes, dhe aq ishte koha që prita” thotë ai, ndersa zyra në Prishtinë “më priti disa herë dhe më takoi në lidhje me mjetet”.

Hapi i regjistrimit te dyqanit riparues nga autoritetet shtetërore në komunë nuk ishte shumë i vështirë dhe procedurat ishin te lehta.

Në këtë moment ai ka marrë me qira një garazh ku punon, që ndodhet vetëm disa metra larg shtëpisë ku ai dhe familja e tij jetojnë në qendër të Gjakovës. Qiraja e garazhit, ku punon biznesi i tij, “nuk është problem, sepse mundem ta përballoj lehtësisht “ thotë ai.

Zt. Mali, i cili jeton me prindërit, nusen dhe dy fëmijët e tij, thotë se ky biznes që ai ndertoi me ndihmën e IOM i ka ndryshuar gjithshka

në jetën e tij. Kushtet e jetesës kanë ndryshuar për mirë në muajt e fundit për atë dhe tani mundet ta përballojë më mirë familjen e tij. “ Nusja ime nuk punon dhe djali i vogël është vetëm 6-7 muajsh. Gjithshka që na nevojitet i mbuloj me këtë biznes”.

Alban Mali beson se dyqani i tij i riparimit po progreson shumë mirë “ pasi më shumë makina po vijnë dita ditës”. Ai ka shumë konsumator të rregullt të cilët kërkojnë shërbimet e tij dhe i besojnë kualitetit të punës dhe eksperiencës së tij. Konkurrenca në këtë profil të biznesit të tij është një faktor tjetër që po ndikon për mirë ne biznesin e tij. Mekanikët e tjerë në zonën e tij janë të specializuar në profile të ndryshme nga ajo e Zt. Mali ( psh: xhameri, lyerje etj) duke i dhënë atij më shumë përparësi për biznesin e tij.

Megjithëse zakonisht ka ulje e ngritje në punën e tij, Alban Mali beson se dyqani i tij do vazhdojë të zhvillohet dhe ai e ka mbyllur derën për ri-imigrim kur thotë se “ nuk do largohet më kurrë”. Pak kohë më parë Zt. Mali mundi të punësoj një punëtor, i cili jeton në të njëjtën zone si ai dhe është i kthyer prej imigrimit si ai. I punësuar nuk mundi të mari dot asnjë asistencë ne kthimin e tij në Kosovë dhe kjo mundësi është një prej te vetme nga ku mund të krijoj disa të ardhura.

Në të ardhmen Zt. Mali ka dëshirë të qëndroj ne Kosovë dhe te vazhdoj punën ne dyqanin e tij mekanik, ku ai ka “shumë klientë dhe shumë miq” që mund ta ndihmojnë ate te rrisi më tepër lidhjet e tij.

### 3. Sadik Klodi – Marangozi

Zoti Klodi u rikthye vullnetarisht ne Kosovë\* me ndihmën e IOM pasi emigrimi i tij për në Suedi u ndalua në Hungari. Duke u rikthyer nën programin e Rikthimit të Asistuar Vullnetar dhe Ri-integrimit të IOM Hungari, Sadiku pati mundësinë për të aplikuar për grant biznesi të mbështeste procesin e ri-integrimit të tij në Kosovë\*.

Ideja e biznesit që Zoti Sadik Klodi aplikoi për Grantin e biznesit me zyrën e IOM Prishtinës ishte për vazhdimin e traditës familjare, të filluar prej gjyshit të tij, si marangoz. Gjyshi i tij ishte marangoz dhe prodhonte tavolina, ndërsa ai vetë “mësoi zanatin prej babait (të tij)”.

Përveç ndihmës së dhënë nga IOM, Sadik Klodi nuk mori asnjë ndihmë prej askujt për të filluar biznesin e tij. Me institucionet shtetërore ai pati kontakt vetëm kur ju desh të regjistronte biznesin e tij, përndryshe siç thotë ai “ ishte ideja ( e tij) dhe (unë) e fillova vetë”. Sadik Klodi u rikthye pas në fshatin ku ai tashmë jeton me familjen e tij dhe punon në biznesin e tij. “ Unë jam i kënaqur që u riktheva” thotë ai në lidhje me kthimin e tij.

Zoti Klodi thotë se është i kënaqur me grantin e marë prej IOM që e ndihmoi atë të fillonte biznesin e marangozisë. Prej grantit të biznesit ai ka tashmë më shumë “mundësi dhe sende” të cilat nuk mund ti kishte më parë. Përmes punës së palodhshme ai mundet të mbështesë familjen duke pasur më shumë të ardhura se kur u largua prej Kosovës\* për më tepër mundësi. “ Kemi gjithmonë para tani “ thotë Sadiku në lidhje me të ardhurat që përfiton prej biznesit.

Në biznesin e tij Zoti Sadik fokusohet më shumë në prodhimin e tavolinave të cilat shiten më pas jo vetëm në rrethinat ku jeton por edhe në zona dhe rajone të tjera si përshebull Drenas, Pejë apo Skënderas. Ky grant ka bërë që ai të jetë shumë optimist për të ardhmen e tij dhe atë të biznesit të tij. “Me punë të palodhshme mundet të kesh sukses” thotë ai, ndërsa në plan ka të zgjerojë biznesin edhe më shumë.

Eksperienca e tij me IOM Budapest dhe Prishtinë ka qënë shumë e mire dhe procesi i aplimit dhe marjes së grantit ishte shumë i lehtë.



Rekomandimi i vetëm që ai ka është rritja e shumës financiare që posedon granti. “ Më shumë para do të ishte më mirë” sipas atij dhe si një sipërmarrës ai do mundet të investonte në më shumë makineri dhe do ishte në gjëndje të rriste kapacitetin e prodhimit së bashku me numrin e të punësuarve. Për këto produkte ka një treg shumë të madh sipas Zotit Sadik Klodi dhe “ sa më shumë punon, aq më shumë mund të shesësh”.

Ky progres dhe sukses i biznesit të tij e kanë bërë atë më shumë optimist për të ardhmen dhe ai rikonfirmon se nuk ka menduar asnjëherë për tu larguar përsëri nga Kosova\*.

## 4. Ilir Toska – Bujqësi

Ilir Toska zgjodhi të kthehej vullnetarisht në Kosovë\* prej Hungarisë. Ai u informua në lidhje me kthimin e asistuar vullnetar dhe grantin e ri-integrimit në qendrën ku akomodohej.

Plani i biznesit që Ilir Toska dorëzoi në zyrat e IOM Prishtinës, kishte si qëllim ndihmesë në blerjen e mjeteve bujqësore. Procesi i marjes së grantit nga IOM ishte “ shumë i lehtë dhe shume korrekt” dhe ai nuk “ pati asnjë gjë të komplikuar”.

Zt. Toska në vitet e mëparshme, kishte marrë edhe një asistencë financiare nga qeveria Kosovare. Gjithsesi në ditët e sotme autoritetet “ nuk mbeshtesin më projekte bujqësore” dhe “ka vetem nje numer te vogel projektesh” sipas atij. Pas kthimit ne Kosove\*, ndihma e IOM ishte ndihma e vetme qe ai mori per te zgjeruar biznesin bujqësor të trashëguar nga familja.

Edhe pse përpara se të largohej nga Kosovo Zt. Toska ishte një mësues në shkollat fillore i gjuhës Shqipe ai ishte i përfshirë në bujqësi pasi familja e tij ka një traditë në punë me agrikulturë ashtu si dhe shume familje te tjera ne fshatin ku jeton. “Më shumë se 20 familje” në këtë



fshat me 120 familje janë të përfshira në agrikulturë sipas Ilirit.

Para se të largohej nga Hungaria Ilir Toska aplikoi për subvencionim page në profesionin e mësuesit në Kosovë\*, një aplikim që nuk mund të finançohej prej ndihmes së projekteve AVRR të IOM. Si rrjedhojë ai vuri në jetë idenë aktuale: “ Pasi u ktheva, nuk kisha shumë ide... por e dija se do të punoja në

bujqësi, prandaj aplikova për atë”.

Suksesi i biznesit të tij varet nga shumë faktor, shpeshherë jashtë kontrollit të tij si përshtetshëm faktorët natyrorë dhe situata ekonomike e vendit që cojnë në paqëndrueshmeri e cmimeve ne treg, e cila vitin e kaluar ishte me e ulet nga sa e kishin planifikuar. Gjithsesi, Zt. Toska është i aftë të gjej menyrat të tjera dhe të mundet të shes produktin e tij, në shumicë në

Prishtinë dhe Prizren, por edhe ne tregjet javore lokale.

Për të bërë ballë faktorëve të sipër përmendur, Zt. Toska është gjithmonë në kërkim të qasjeve më kreative. Momentalisht ai gjithashtu përdor farërat e tij si produkte për të shitur te fermerët e tjerë në zonën ku jeton. Siç ndodh zakonisht në kontekstin e Kosovës, ai ka mundur të shtojë klientelën e tij të farërave nëpërmjet njohjeve

dhe lidhjeve informale në zonë.

Asistenca e marrë prej IOM, përveç se të qenit një forcë stabilizuese për jetën e tij në Kosovë\*, ka gjithashtu zhvilluar kushtet e punës dhe teknologjinë e përdorur në bujqësi. Kushte më të mira pune dhe përmiresim i mjeteve teknologjike i kanë dhënë atij mundësinë e pasjes më pak punë krahu në fushë. Për më tepër këto zhvillime kanë

mundësuar punë më të shpejtë dhe më shumë produkte.

Zt. Toska e shikon ndihmën e IOM si një faktor të madh që e ndihmoi atë në stabilizimin dhe qendrueshmërinë në Kosovë\*. Asistenca e marrë e ndihmoi atë dhe familjen e tij të vendosin rrjetin elektrik në serat e tyre. Po ashtu vendosja e sistemit të ngrohjes nëpër sera do të rriste shumë potencialin prodhues, i cili në moment është në nivelin 60%. Për më tepër, sistemi i ngrohjes në sera, i cili është një prej planeve të Zt. Toska, do të rriste mundësinë e hyrjes në tregjet në një kohë më parë se tjetërët dhe jashtë sezonit, gjë që do rezultonte në cmime më të larta për produktet e tij.

Përveç zgjerimit të sistemit të ngrohjes në serat e tjera, ai dhe familja e tij kanë në plan të zgjerojnë sistemin e ujitjes të tokës dhe shtimin e serave. “ Në qoftëse do kisha mundësi për të bërë më shumë, mund të bëja dhe 10 deri në 15 më shumë “ thotë Ilir Toska në lidhje me serat. Planet e të ardhmes ishin në proces e sipër gjatë vizites tone te Iliri. Në parcelat të ndryshme kishte që tani sera të reja që po ndërtoheshin prej tyre. “ Kur njeri mundohet dhe nëse ka vullnet, ka më shumë shanse për të pasur sukses” ishin fjalët e të atit të Ilir Toskës.

## 5. Nertil & Enver Sulejmani – Ndërtim

Nertil dhe Enver Sulejmani janë dy kushërinj , shumë të lidhur me njeri tjetrin, të cilët emigruan së bashku prej Kosovës dy herë. Të dyja herët ata u larguan prej Kosovës\* së bashku për në Francë, me shpresën për të marrë statusin e azilantit, por u ndaluan në Hungari. Në përpjekjen e dytë për të emigruar në Francë ata zgjedhën të kthehen vullnetarisht nga Hungaria.

Për faktin se ata morën pjesë në programin e kthimit vullnetar, në aeroportin e Budapestit përpara nisjes së tyre ata u konsultuan nga punonjës të IOM Budapest mbi mundësitë e marrjes së asistencës së ri-integrimit. Pasi u kthyen në Kosovë Nertil dhe Enveri aplikuan në një partnerшип për grantin e biznesit të zyrat e IOM në Prishtinë.

Sëbashku me te atin e Enver Sulejmanit, I cili është një mbështetje e madhe, të tre vazhduan të zgjerojnë më shumë biznesin e ndërimit të mëparshëm dhe përdorën fondet e mara prej asistencës për të blerë mjete të ndryshme

Enveri dhe Nertil filluan të meren me ndërtim duke ndihmuar babain/xhaxhain e tyre pasi mbaruan shkollën e mesme. Prej asaj kohe ata morën eksperiencë të madhe në atë fushë dhe mund të quhen ustallare të zotët. I ati I Enverit është zakonisht personi që menaxhon biznesin, I cili duke përdor njohuritë dhe kontaktet e mëparshme gjen kliente dhe punë për biznesin. Ndihma dhe eksperiencia e tij e ka bërë tepër të lehtë ngritjen e biznesit për ta.

Granti I biznesit I dhënë prej IOM-it ishte ndihma financiare e vetme që kushërinjtë morën për biznesin e tyre të ndërtimit. Për të dy, roli I familjes në mbështetjen e biznesit është shumë I rëndësishëm, por fatkeqësisht ata nuk mundën të sigorinin ndihmë financiare nga ndonjë pjesëtar I familjes.

Edhe pse deri më tani kushtet e tyre të jetesës nuk kanë ndryshuar drastikisht, asistencën e marrë I ka ndihmuar ata shumë në mundësinë e punësimit. “Më ka ndihmuar edhe më tepër mua, pasi jam I punësuar me ta, dhe ka më shumë punë” thote Nertil Sulejmani. Për më tepër me fondet e mara, kushërinjtë mundën të blenin pajisje më të mira, duke I lehtësuar punën e krahut dhe shpejtuar punën më tej. “ Është shumë më mirë tani jeta sepse kemi me pak punë fizike” deklaroi Enveri.

Situata politike dhe ekonomike në shtetin e tyre ndikon negativisht në biznesin e tyre të ndërtimit sepse njerzit nuk kanë të ardhura për të paguar për këto shërbime, sipas atyre. Megjithatë biznesi



I tyre, sipas të dy kushërinjve, po shkon shumë mirë pasi projektet në të cilat ata punojnë janë shumicën e kohës në Shqipëri, e cila është në një distancë relativisht të vogël prej vendit të banesës së tyre, 75 kilometra. Ata vendosën të punojnë më shumë në veri të Shqipërisë sepse “ pagesa aty është më e mirë”. Për më tepër, për shkak të shumë viteve të punës që I ati I Enverit ka bërë në Shqipëri, ai “ ka shumë miq dhe kontakte” aty, të cilat janë burime të rëndësishme për këto lloj biznesi.

Gjatë nëntë muajve të vitit që ata punojnë, ka pasur “ shumë shpesh” raste ku ata duhet të anulonin punë. “ Nuk kishim kohë për të shkuar” thone ata, të cilët vetëm në 2014 ju desh të mos pranonin pesë kliente. “Vitin e kaluar ne kishim rreth 20 kontrata që punuam” ndërsa tani me pajisje më të mira dhe kushte pune më të lehta po parashikojmë edhe më shumë.

Duke u fokusuar më shumë në ndërtesa banimi, dhe punë me fasadat dhe hidroizolimet e shtëpive ata mund të mbështesin familjen prej 15 anëtarësh.

Edhe pse ata “ asnjëher nuk menduan se do ta merrnin asistencën”, dy kushërinjtë kujtojnë sesi procedurat për marrjen e asistencës ishin shumë të mira dhe sesi ata nuk patën asnjë vështirësi në asnjë prej staveve të procesit. Ata e konsiderojnë atë proces si të lehtë dhe pa asnjë pengesë apo sfidë. Gjithsesi ata dëshmojnë se një prej vendeve ku mund të ketë përmirësim mundet të jetë shpejtësia e marrjes së grantit. Atyre ju desh të prisnin 6 muaj për gjithë procesin e aplikimit dhe marrjen së grantit.





## 6. Faik Kulla - Pllaka-shtrues

Faik Kullës ju desh të priste një muaj në qendrën e pritjes Kiskunhalas në Hungari përpara se të kthehej vullnetarisht në Kosovë\* me ndihmën e programit AVRR të IOM. Përpara nisjes së tij, në aeroport ai u informua mbi mundësitë e aplikimit për grant biznesi në zyrat e IOM Prishtinës, si një ndihmë për ri-integrimin dhe stabilizimin e jetës në Kosovë\*. Granti që

ai aplikoj për ri-integrimin e tij ishte për financimin e blerjes së mjeteve për biznesin e tij si pllaka-shtrues, i cili që prej asaj kohe po korr sukses.

Zt. Kulla ka punuar gjithmonë në biznes pllaka shtrues, edhe përpara se të largohej nga Kosova\*. Vendimi për tu larguar prej Kosove ishte një vendim i vështirë për Zotin Kulla, por situata e rëndë ekonomike e detyroi atë të emigronte për në Gjermani dhe të provonte fatin e tij si pllaka shtrues aty.

Përmes grantit të marë Faik Kulla bleu mjete të reja për të vënë në punë njohuritë e tij. Këto njohuri dhe kualiteti i punës së tij ka bërë që ndërmarja e tij e vogël të lulëzojë. Ky kualitet që ai siguron për klientët e tij është shumë i rëndësishëm në krijimin e besimit që duhet për të krijuar klientelë por edhe për të mbajtur dhe zgjeruar atë me tej.

Situata për atë dhe familjen e tij ka ndryshuar për më mirë pas marjes së mjeteve dhe

përmirësimit të biznesit të tij. Faik Kulla beson se nëse do të kishte të njëjtat mjete dhe kushte në kohën kur vendosi të emigronte ai nuk do të largohej për emigrim në Gjermani.

Biznesi i tij pllaka shtrues ka qenë një sukses më vete. Prej të ardhurave nga biznesi ai ka mundur të paguaj të gjitha borxhet të cilat ai kishte marë për të ndihmuar atë në migrimin prej Kosove\*. Për më tepër sukcesi i biznesit të tij shihet në faktin se ai tashmë puneson



dy prej vëllezërve të tij, duke bërë të mundur që edhe dy familjare të tjera të përfitojnë nga asistenca e marë. Për biznesin e tij ka kërkesë shumë të madhe në Kosovë\*. Për këtë arsye ai planifikon që në të ardhme të mbaj stabel biznesin e tij. Edhe pse të ardhurat prej biznesit nuk lejojnë të ketë një jetë luksoze, ai është në gjendje të mbuloj shpenzimet bazë dhe ditore për ushqime për veten e tij dhe pjestarët e tjerë që varen prej tij.

Granti i biznesit prej IOM ishte ndihma e vetme që ai mori në kthimin e tij në Kosovë\*. Ai nuk mundi të mari asnjë ndihmë prej shtetit, dhe i vetmi kontakt që ka pasur me institucionet shtetërore ishte kur i duhej të rregjistronte biznesin e tij. Ai thotë që është shumë i kënaqur me shërbimin e ofruar prej IOM. Për atë në këtë moment gjithëshka duhet të bëjë është “te fokusohet sesi të zhvilloj më tepër biznesin, që është dhe shqetësimi i vetëm”.

Që prej kthimit dhe marjes së asistencës, Zoti Kulla nuk ka menduar më për largim nga

Kosova\*. Në të kundërt, ai dëshiron të zgjeroj biznesin e tij, të këtë mundësinë të mari përsipër kontrata dhe punë më të mëdha, ose të blejë më shumë mjete me ndihmën e ndonjë asistence tjetër. Me zgjerimin e biznesit të tij atij do i duhet më shumë ndihmë, dhe rrjedhimisht më shumë punëtorë, përveç vëllezërve të tij. Ai thotë se në muajt e fundit ishte shumë e lehtë për atë të emigronte përsëri, por nuk i shkoi në mendje as edhe për një moment “sepse po përqëndrohëm për të ndërtuar diçka këtu”.

Faik Kulla e konsideron procesin e aplikimit dhe marjes së grantit të ri integritit si një proces relativisht të lehtë. Pas plotesimit të formularëve dhe krijimit të planit të biznesit, procesi shkoi rrjedhshëm.

Në lidhje me rekomandime të ndryshme për zyrat e IOM Budapest dhe Prishtinë, ai thotë se detyrimi i tyre për mbështetje me mjete dhe para u mbajt shumë mirë, ndaj nuk ka asgjë që zyrat e IOM mund të bëjnë më mirë.

## 7. Bujar Fusha – Agrikulturë

Bujar Fusha u rikthye në Kosovë\* në vitin 2013 nga Hungaria, ku u ndalua duke kaluar kufirin ilegalisht përmes Serbisë dhe Hungarisë. Më përpara ai kishte jetuar gjithsej 17 vjet jashtë shtetit në dy kohe të ndryshme. Të dyja herët ai jetoi në Gjermani. Në 2013 ai u rikthye në Kosovë\* si pjesë e programit të kthimit vullnetar të asistuar të IOM. Pas kthimit në Kosovë\* dhe pasi vizitoi zyrat e IOM në Prishtinë ai aplikoi për asistencën e ri integritetit nga IOM që të mund të ndihmonte biznesin e familjes së tij në agrikulturë.

Zt. Fusha dhe familja e tij ishin pronarë të tokës që po perdorin momentalisht. Por, para se të merrnin asistencën, dhe para rikthimit të tij, familja nuk ishte në gjendje për ta punuar atë tokë “ me ato mundësi dhe kushte” që ndodheshin. Për këtë arsye asistencën e IOM ka qenë një ndihmë e madhe për atë dhe familjen e tij.

Asistencën e ofruar prej IOM u përdor për blerjen e një makinerie për punimin e tokës. Kjo makineri shtoi së tepërmi efikasitetin e punës dhe e bëri atë më të lehtë se më parë, pasi më parë toka punohej me punë krahu.

Zt. Fusha beson se kushtet e tij të jetesës janë bërë më të lehta dhe jeta e tij është përmirësuar shumë. Prej një makinerie



të re ai mund të nxjerri më shumë profite nga agrikultura. Për më tepër, makineria që ai posedon e lejon atë të ketë më shumë punë dhe të mund të punoj tokën e fermerëve të tjerë. Në këtë mënyrë ai mund të mbulojë pa probleme shpenzimet e familjes dhe disa prej parave që fiton ti ri-investoj në biznesin e tij të agrikulturës. Këto rezultate i ka dhënë mundësinë Zt. Fusha të punësojë një punëtor në biznesin e tij. Gjatë momentit të intervistës ai nuk kishte

punësuar asnjë për shkak të ulje-ngritjeve në biznes, por “ndodh, rast për rast” thotë ai.

Zt. Fusha akoma nuk e ka krijuar familjen e tij; ai është i fejuar dhe ka në plan për tu martuar në verë. Momentalisht ai jeton me prindërit e tij dhe dy vëllezërit/motrat e tij. Të afërmit e tij jetojnë afër shtëpisë së tij dhe ata punojnë së bashku, bashkpunojnë dhe ndihmojnë njeri tjetrin. Ai ka mbeshtetje nga familja e tij “ në çfardo mënyrë” që kur ai u

kthye në Kosovë\* dhe deri në këto ditë.

Zt. Fusha është i kënaqur dhe mirënjohës për asistencën që ai mori prej IOM, pasi pa atë ai nuk do të mundte të ngrinte biznesin e tij. Përveç grantit të biznesit nga IOM, ai nuk mori asnjë lloj ndihme tjetër nga shteti, pasi nuk mund të plotësonte kushtet. Veç kësaj kompensimet e shtetit vazhdojnë të jenë të limituara, veçanërisht në rastet e dëmtimeve natyrale që në sektorin e agrikulturës janë të shpeshta.

Bujar Fusha ka plane të qarta për të ardhmen e biznesit të tij. Me pak më shumë asistencë ai do mund të nisi fermë bagëtish përgjatë biznesit të agrikulturës. Duke mbajtur bagëti do të mund të ketë më shumë të ardhura sepse “vlera e mishit nuk bie kurrë” dhe në këtë mënyrë do të mund të sheshe dhe produktet të tjera si qumesht, djath e kos. Me kalkulimet e bërë prej tij, atij do i duhen pesë lopë për të filluar fermën, të cilat kushtojnë afërsisht 10,000 euro investim.

Edhe pse ai e shikon fermën e bagëtive si me më shumë vlerë dhe të ardhura, ai nuk planifikon të ndalojë punimin e tokës së tij. Me të mbjellën ketu ai do mund të ushqejë lopet, domethënë me të mbeturat e barit nga agrikultura ai e riciklon për ushqim për lope. Në këtë moment, barin, ai e shet te fermerë të tjerë në rajonin ku jeton, por siç thotë ai, duke e përdorur për nevojat e tij në bagëti mund të ketë “ më shumë të ardhura”.

## 8. Flamur Kodra – Dekorime

Flamur Kodra u rikthye në Kosovë\* në vitin 2010 me ndihmën e programit AVRR të IOM. Pas kthimit të tij, ai aplikoi për asistencën e ri integritit në forme grant bizensi te zyrat e IOM në Prishtinë brenda një muaji. Fillimisht ai ishte larguar nga Kosova për shkak të mundësive ekonomike. Zt. Kodra mësoi për mundësinë e kthimit vullnetar të asistuar dhe ri integrimi nga stafi i qendrës së ndalimit, emigrantë të tjerë dhe stafi i qendrës së pritjes.

Kur ai aplikoi për grantin e biznesit idea e tij fillestare ishte përdorimi i asistencës së IOM për te ndihmuar në hapjen e biznesit të dekorit. Flamur Kodra vendosi të ri hapte biznesin e dekorit që ai kishte më parë, në te cilin ai ka pesë vjet eksperiencë para se të largohej prej Kosovës\*. Ai gjithmonë ka qenë i dhënë pas biznesit të dekorimeve, të cilin e ka pasur ëndërr që kur ka qenë fëmijë.

Përveç asistencës së ri-integritit te IOM, Zt. Kodra mori ndihmë prej familjes dhe kursimeve të tyre, të cilat ai akoma i sheh si të rëndësishme në ëndrën e tij. Ndihmë prej qeverisë dhe institucioneve të tjera ishte e pamundur për atë pasi nuk përmbushte kushtet si i rikthyer në Kosovë\* pas vitit 2008.

Momentalisht biznesi i tij është operacional dhe mundëson një të ardhur të qendrueshme me të cilën Zt. Kodra mbështetë gjashtë pjesëtar të familjes. Biznesi i Zt. Kodra ofron dekorime të punuara në sipërfaqe të ndryshme, si psh: dru, metal, plastike, styropor, zakonisht të punuara me gurë dhe kristale që shprehin tema të ndryshme. Shumicën e produkteve të tij ai e punon për diasporën Kosovare. Gjithsesi një pjesë e madhe e punës së



tij prodhohet për popullatën e vendit gjithashtu.

Biznesi i tij po fillon të përjetojë një shkallë të vogël eksporti dhe Zt. Kodra ka plane për të rritur më tepër kapacitetin e tij. Ai ka dëshirë të promovojë produktet e tij te emigrantët Kosovarë që jetojnë jashtë shtetit.

Përmes biznesit të tij Zt. Kodra ofron punë në dizajn të ambienteve të brendshme,

zakonisht të bizneseve të ndryshme dhe fasadave që i punon nëpërmjet dekorimeve dhe lyerjve të ndryshme.

Granti i marë zgjidhi problemet që e detyruan atë të largohej prej Kosovës\* dhe për momentin ai nuk ka në plan të largohet përsëri pasi ai e konsideron veten të jetë në një situatë më të mirë se kur u largua.

Zt. Kodra është i kënaqur me asistencën e ri-integritit që përfitoi nga IOM Hungary dhe Kosova\*. Ai nuk pati asnjë problem apo vështirësi në procesin e marrjes së grantit; procesi ishte i qetë, i qartë dhe relativisht i shpejtë. Ai do dëshironte të propozonte rritjen e shumës së grantit që mund të mari një person. Në përgjithësi Flamur Kodra beson se granti ishte i domosdoshëm, por i vetëm ai nuk do mund të ishte i mjaftueshëm për ri-integritimin e tij.

Në të ardhme, Zt. Kodra do të dëshironte të zgjeronte biznesin e tij prej të ardhurave që ai nxjerr nga ky biznes. Ai thotë se ky biznes ka shumë potencial, pasi për momentin ska asnjë konkurrencë në treg. Blerja e mjeteve të reja dhe krijimi i punëtorive të ndryshme është një prej mënyrave për të arritur objektivat e tij.

Planet e tjera për Flamur Kodrën përveç atyre të biznesit, përfshijnë stabilimin e tij në Kosovë\* dhe të martohet së shpejti.



## 9. Dorian Dielli – Edukim IT

Dorian Dielli mësoi për programin AVRR të IOM nga punonjësit social në qendrën e pritjes së Kiskunhalas, ku ai ishte akomoduar. Gjithashtu linja telefonike shumë-gjuhëshe e IOM i dha atij informacione më tepër në lidhje me procesin e kthimit vullnetar dhe mundësitë për asistencë ri-integrimi që ai mund të përfitonte.

Ai vendosi të marrë pjesë në projektin AVRR të IOM dhe përpara se të kthehej në Kosovë\* ai dorëzoi aplikimin për asistencën e ri integritit të IOM Budapest. Në zyrën e IOM në Prishtinë ai mori informacione dhe ndihmë të mëtejshme për procedurat dhe

procesin. Pasi dorëzoi aplikimin atij ju desh të priste rreth një muaj për të marrë grantin.

Ndihma financiare e IOM ishte mbështetje e vetme që ai mori në ndihmë të ri integritit të tij në Kosovë\*. Deri tani, ai është akoma në nevojë të ndihmave të tjera financiare për të qenë i aftë të ketë një jetesë në Kosovë\* për shkak të vështirësive ekonomike.

Zt. Dielli aplikoi për asistencë edukimi me IOM dhe bashkë me të ai përfitoi edhe nga “ndihma urgjente”. Asistenca e marrë i dha mundësinë e edukimit në fushën e informatikës dhe teknologjisë, dhe për të lehtësuar studimet atij ju dha një laptop.

Kursi i IT që Zt. Dielli ndjek është në Universitetin Amerikan në Kosovë, një prej Universiteteve më prestigjioze në vend, dhe shumë i konsideruar nga punëdhënësit në vend. Stafit i Universitetit dhe stafit që punon direkt me Dorian Diellin e përgëzojnë atë për sjelljen dhe angazhimin e tij gjatë studimeve.

Pas diplomimit nga universiteti, Dorian Dielli do të jetë një instructor CISCO i çertifikuar, gjë që do i rrisi në mënyrë drastike mundësitë e tij në tregun e punës në Kosovë\*.

Komuniteti ku ai u kthye ishin në fillim skeptik për asistencën e ri integritit që ai mori, por

ai mori shumë mbështetje nga prinderit, me të cilët ai momentalisht jeton.

Ai u largua nga Kosova\*, për shkak të mundësive më të shumta ekonomike dhe studimi jashtë shtetit, por pas kthimit, plani ri integruar në një far mënyre i ka zbutur ato probleme që e motivuan atë drejt largimit.

Ai është i kënaqur nga informacioni dhe keshillimi për ri integritin që ai mori në Kosovë\* dhe Hungari. Por, si keshillë, Zoti Dielli propozon shpjegimin e procesit të aplikimit dhe evaluimit, pasi atij ju desh të priste 4 muaj. Gjithashtu ai propozon rritjen në maximum të shumës nga cka dikush mund të përfitoj.

Dorian Dielli beson se ai është në gjendje më të mirë se kur u largua nga Kosova dhe ai është i kënaqur me vendimin e bërë për tu rikthyer. Në të ardhmen, Zt. Dielli do të dëshironte të kishte një punësim më të mirë.



## 10. Fatos Tokaji – Bujqësi

Fatos Tokaji vendosi të kthehet vullnetarisht në Kosovë\* përmes programit të kthimit vullnetar të IOM. Brenda një muaj pas kthimit të tij, ai aplikoi për asistencë në ri-integrimin e tij përmes një granti biznesi të zyrat e IOM në Prishtinë. Arsyeja kryesore e largimit të tij nga Kosova\* ishte gjendja e mjerë ekonomike dhe shpresa për më shumë mundësi jashtë. Zt.Tokaji u informua për mundësinë e kthimit vullnetar të asistuar dhe grantit të ri-integrimit përmes

emigrantëve të tjerë, stafit të qendrës dhe gjithashtu nga stafi i IOM që vizitoi qendrën ku ai ishte akomoduar.

Familja e tij ka qenë e përfshirë me bujqësi për një kohë të gjatë tashmë. Zt. Tokaji vendosi të përdori fondet e asistencës për blerjen e një motor-kultivatori

për parcelën e vogël të tokës që familja e tij posedon. Një pjesë të asistencës ai e përdori për blerjen e më shumë paisjeve për të rritur produktivitetin.

Përpara largimit të tij, Zt. Tokaji kishte 6 vjet eksperiencë në bujqësi. Kjo asistencë ishte një ndihmë e madhe për zbutjen e disa prej problemeve të tij dhe ai mendon se momentalisht është në një situatë më të mirë se përpara largimit prej Kosovës\*. Edhe pse situata ekonomike nuk është e sukseshme ashtu siç do e dëshironte, ai është i kënaqur me vendimin për kthimin në Kosovë\*. Në të njëjtën kohë ai nuk e ka menduar më asnjëherë largimin përsëri nga Kosova pas marrjes së asistencës së IOM.

Biznesi që Fatos Tokaji nisi me ndihmën e IOM është funksional për momentin, por nuk gjeneron të ardhura akoma. Mungesa e të ardhurave sipas tij vjen nga fakti se vetëm në fillim të sezonit veror do të mund të vëjë në funksion motor-kultivatorin dhe fushat e kultivuara do të japin frytet.

Zoti Tokaji jeton me familjen e tij, me prindërit, vëllain dhe motrën. Përpos grantit të IOM ai përdori dhe kursimet e familjes si dhe u mbështet shumë në ndihmën e familjes në hapat e parë të biznesit. Por ai nuk more asnjë lloj ndihme financiare nga shteti.

Fatos Tokaji është i kënaqur prej asistencës së ri-integrimit që ai përfitoi prej IOM Budapest, edhe pse siç thotë ai, do preferonte nëse koha e pritjes për aprovimin nga IOM Budapest të ishte më e shkurtër dhe procesi i evaluimit nga IOM Prishtina më i shpejtë. Reagimi i tij kryesor për të dy zyrat do ishte të përmirësonin procesin e marrjes së grantit.